



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:141065
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06107105

Ac.nr.6194/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ECO-HIGJIENA” SH.P.K, me seli në Gjilan, rruga “Fehmi Agani” nr.17, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.O., kundër debitorit B.H. nga Gjilani, rruga “...” nr..., me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.48/20 të datës 05.07.2022, me datë 30.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit “ECO-HIGJIENA” SH.P.K, me seli në Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.48/20 i datës 05.07.2022, në pikën I dhe II të dispozitivit **VËRTETOHET**.

II. Pika III e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, CPK.nr.48/20 të datës 05.07.2022, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar CPK.nr.48/20 të datës 05.07.2022, në pikën I, të dispozitivit ka pranuar si të bazuar prapësimin e datës 04.03.2020, i paraqitur nga debitori B.H. nga Gjilani, kundër urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat Sefer Sh. Arifi, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 105/2020, të datës 27.02.2020. Në pikën II, ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor të përmbartuesit privat Sefer Sh. Arifi, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 105/2020, të datës 27.02.2020. Në pikën III, ka detyruar debitorin Bashkim Haziri, që kësaj gjykate t’ia paguaj taksën për ushtrimin e prapësimit në shumë prej 20 €.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, shkeljes së dispozitave materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e kreditorit, të ndryshoj në tërësi aktvendimin e atakuar dhe të refuzoj prapësimin si të pabazuar apo të anuluj aktvendimin e atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 27.02.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për bartjen e mbeturinave nr.107012, lidhur me borxhin në vlerë prej 200.00 euro. Përmbartuesi privat, ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin përmbartimor P.nr.105/20 të datës 27.02.2020, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 04.03.2020, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 09.03.2020. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka konstatuar se kreditori me rastin e dorëzimit të propozimit për lejimin e përmbartimit tek përmbartuesi privat, propozimit nuk i ka bashkangjitur edhe ekstraktin e verifikuar nga libri afarist për pagesat e shërbimeve nga ana e debitorit karshi kreditorit, por të njëjtit propozim i ka bashkangjitur vetëm kartelën e konsumatorit, e cila kartelë është e paqartë dhe e pakuptueshme ngase sipas kësaj karte nuk mund të verifikohet as periudha kohore sipas muajve nga e cila ka rrjedhur ky detyrim sipas kreditorit, e as nuk mund të vërtetohet me saktësi shuma e detyrimit e kërkuar nga i njëjti nga se sipas kësaj karte shuma në lartësi prej 200.00 €, e cila kërkohet nga ana e kreditorit është e shënuar me dorë të lirë ku shkruan vetëm se “borxhi total 200 €”, andaj duke u bazuar në arsyet e lartcekura gjykata vendosi si në të dispozitivin të aktvendimit të atakuar. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 5, 29, 71, 72, dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar prapësimin e debitorit, ngase sipas nenit 29 par.1, nënpar.1.2 të LPP-së është paraparë së “*Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa sipas paragrafit 3 të këtij neni është paraparë së “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në rastin konkret kartela e konsumatorit në bazë të secilës është paraqitur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar përmbarrimi nuk i plotëson kushtet ligjore të dokumentit të besueshëm dhe të përshtatshëm për përmbarrim ashtu siç kërkohet me dispozitat e lartcekura. Kjo pasi që sipas përmbajtjes së kësaj kartele nuk mund të dihet së cilës periudhë kohore i referohet ky borxh ashtu siç rëndom pasqyrohet në ekstraktin afarist, por vetëm është paraqitur shuma totale e borxhit të cilin kreditori pretendon që ia ka borxh debitori.

Sipas dispozitës së nenit 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: “*...Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim*”. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të prapësimin ka vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim dhe me të drejtë ka shfuqizuar urdhrin përmbarrues për faktin se nga kartela e paraqitur nga kreditori nuk mund të verifikohet periudha kohore sipas muajve nga ka rrjedhur detyrim i kërkuar sipas kreditorit si dhe nuk mund të vërtetohet me saktësi shuma e detyrimit e kërkuar.

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranoj si të bazuar pretendimin ankimor të kreditorit se kartela e klientit është e qartë dhe lehtësisht e kuptueshme, në të cilën është evidentuar periudha kohore, shërbimi i ofruar, pagesat e kryera nga klienti dhe se kartela e klientit mund të ketë një apo më shumë faqe, varësisht për sa vite është fjala. Në rastin konkret, nga kartela e klientit nuk mund të kuptohet periudha kohore për të cilën kërkohet borxhi, pasi që kartela përmban datën e regjistrimit dhe datën e dokumentit 01.01.2020, 31.01.2020, ndërsa tek përshkrimi i veprimit konstatohet: Gjendja deri me datën 01.01.2020, pa e specifikuar se si ka rrjedhur detyrimi, ashtu që kartela nuk përmban secilin muaj veç e veç, në mënyrë që të mund të vlerësohet edhe pretendimi për parashkrim i paraqitur nga debitori. Andaj, në bazë të asaj që u tha më lartë aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të vërtetohet dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktvendimin e atakuar në pikën III të dispozitivit, pasi që nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Numri i lëndës: 2022:141065
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06107105

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6194/2022, datë 30.08.2024

Gjyqtari
Hysni Bardheci